



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201800148/9

Tiranë ____/____/2018

Lënda: *Rekomandohet disiplinimi i veprimeve që kryehen në sektorin e dhomave të takimit me avokatin, prokurorin, familjarët etj., në IEVP në Rrugën "Jordan Misja"*

Drejtuar: **Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve**
 Z. Arben ÇUKO

Drejtorit të IEVP në Rrugën "Jordan Misja" (313)
Z. Maksim HAMITI

TIRANË

Të nderuar Zotërinj,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë i paraburgosuri F. D., i cili pretendon se në paraditen e datës 25.01.2018 është kërcënuar dhe goditur nga i paraburgosuri E. Sh. dhe disa shokë të tij, bashkëvuajtës në IEVP 313, Tiranë. Ky konflikt është nxitur nga edukatorja A., së cilës F. D. i është ankuar disa ditë më parë për shërbimin e stomatologjisë që atij i mohohej, ndërsa E. Sh. Ky i fundit dhe shokët e tij (E. V. dhe dy bashkëvuajtës të punësuar si shpërndarës të sendeve të të paraburgosurve) kanë arritur ta kërcënojnë dhe ta godasin falë edhe bashkëpunimit me punonjës të policisë. Kjo ngjarje ka ndodhur në një nga dhomat që përdoret kryesisht për takimet me avokatët, OPGJ, prokurorët gjatë kohës që F. D. priste të merrte takim me familjarët.

Për verifikimin e kësaj ankese janë kryer veprimet hetimore si vijon: marrja e deklarimeve me shkrim nga i paraburgosuri F. D.; kqyrja e regjistrit të hyrje-daljeve të të paraburgosurve në ambientin e dhomave që përdoren kryesisht për takimet me avokatët, OPGJ, prokurorët etj.; kqyrja e regjistrit të hyrje-daljeve të personelit në katin e 3 sektori 3-3; kqyrja e regjistrit të hyrje-daljeve të të paraburgosurve në sektorin 2-1 të katit të dytë; kqyrja e kamerave të sigurisë; kqyrja e kartelës stomatologjike të të paraburgosurit F. D.

Në përfundim të hetimit u arrit të provohen pjesërisht pretendimet e të paraburgosurit F. D., vetëm për sa i përket faktit që i paraburgosuri E.Sh. dhe tre të paraburgosur të tjerë kanë hyrë beftas në dhomën ku ai po priste të takonte familjarët, në sektorin e takimeve me avokat, opgj etj. Kjo ngjarje ka ndodhur paraditen e datës 25.01.2018.

Thëniet e të paraburgosurit F. D. që lidhen me vendin, datën dhe orarin se ku dhe kur ka ndodhur kërcënimi përputhen me të dhënat e përfituara nga kqyrja e pamjeve të kameras së sigurisë. Pamjet e kameres së sigurisë kanë provuar gjithashtu se i paraburgosuri E. Sh. dhe tre bashkëvuajtës të tjerë kanë hyrë beftas në dhomën ku i paraburgosuri F. D. po priste të takonte familjarët dhe kanë qëndruar aty rreth një minut. Dy prej të paraburgosurve që i kanë ardhur në krah E. Sh. mund të identifikohen si persona të punësuar për të shpërndarë sendet e të paraburgosurve të tjerë pasi vihet re se ata kryejnë lëvizje të shpeshta me çanta në duar. Institucioni i Avokatit të Popullit nuk mund të identifikojë të paraburgosurin e tretë që i ka ardhur në krah E. Sh., i cili sipas Fitim Dumanit është E. V. Sipas regjistrave të hyrje-daljeve të të paraburgosurve, E. V. ka hyrë në sektorin ku ka ndodhur ngjarja në orën 12:48 dhe ka dalë në orën 14:00. Nëse ky shënim është i saktë, E. V. nuk ka qenë i pranishëm gjatë ngjarjes pasi kjo ka ndodhur në orën 10:56. Gjithashtu nuk mund të provojmë pretendimin e F. D. se, edukatorja A. ka nxitur konfliktin ndërmjet të paraburgosurve dhe se punonjës të policisë kanë bashkëpunuar në këtë rast. Megjithatë nga hetimi kanë dalë në pah disa problematika që lidhen me sigurinë në ambientin e takimeve.

Për të kuptuar dinamikën e ngjarjes dhe problematikat që lidhen me sigurinë është e nevojshme të përshkruajmë ambientin e takimeve. Në IEVP 313, dhomat e takimit me familjarët dhe ato të takimit me avokatin, OPGJ etj. ndodhen në dy vende të ndryshme dhe lidhen ndërmjet tyre me një hapësirë ku është i vendosur një prej punonjësve të policisë që shërben në këtë ambient. Në dhomat e takimit me avokatin, në mungesë të një dhome prindërimi, zhvillohen ndonjëherë edhe takime të të paraburgosurve me fëmijët e mitur pasi ato kanë një pamje më miqësore. Të paraburgosurit që do të marrin takim me familjarët në dhomat e posaçme për këtë qëllim duhet të kalojnë fillimisht në koridorin e dhomave të takimit me avokatin. Nëpër këtë koridor kalojnë edhe personat që futen në regjim. Gjithashtu, në njërin krah të këtij koridori ndodhet dhoma e stomatologes, dhoma e infermierisë, palestra dhe njësia tregtare. Pra, në një hapësirë të vogël ofrohen disa shërbime dhe ka një lëvizje të dendur personash (të paraburgosur, personel dhe vizitorë të jashtëm).

Koridori i dhomave të takimit me avokatin mbikqyret vetëm nga një kamera e vendosur mbi derën që çon për te sektorët e banimit (kamera K60G1K3). Cilësia e pamjeve është e dobët dhe objektivi i kameras kap vetëm në largësi fundin e koridorit. Ora e kamerave nuk është e njëjtë me atë të orëve të punonjësve të policisë që shënojnë veprimet në regjistra. Ora e kamerave është rreth 10 min para orës së punonjësve.

Duke ju referuar pamjeve të kameras (4 orë xhirime nga 09:00 deri në 13:00), shënimeve të mbajtura në regjistrin e hyrje-daljeve të të paraburgosurve, deklarimeve të Fitim Dumanit dhe kqyrjes në vend të ambieteve provohet sa më poshtë:

F. D., i veshur me tuta gri, ka hyrë në sektorin e takimeve me avokatin, OPGJ etj. në orën 10:51:00 për të marrë takim me familjarët, ndër to edhe me fëmijën e mitur. Ai ka qëndruar në pritje të takimit në derën e dhomës nr.6 përballë me dhomën e infermierisë. Vetëm dy dhoma në këtë sektor kanë të shënuar në derë numrin, përkatësisht dhoma nr.6 dhe dhoma nr.7. Në regjistrin e hyrje-daljeve të të paraburgosurve përgjithësisht nuk shënohet se në cilën dhomë i paraburgosuri kryen takimet. Në të njëjtën kohë me F. D., në këtë sektor është ndodhur edhe E. Sh., i cili ka hyrë gjithsej katër herë, tre herë për të ushtruar aktivitet fizik në palestër dhe një herë për takim pa u sqaruar me kë. Në orën 10:55:17, E. Sh. ka dalë nga palestra dhe ka qëndruar në koridor me në krah një prej të paraburgosurve bartës. Ky i fundit ka veshur tuta ngjyrë gri të çelët dhe poshtë mban një bluze portokalli. Në orën 10:56:33 E. Sh. duket të shkëmbejë fjalë me një prej punonjësve të policisë që shërben në regjim dhe pak çaste më pas, nga krahu i hyrjes për në regjim, vjen në koridor me nxitim një i paraburgosur tjetër. Ky i paraburgosur është shtatgjatë, i hollë në trup, flokët e zeza i ka të prera shkurt dhe të rruara në anë të kokës, është i veshur me xhinse dhe xhaketë të zezë. Gjatë kqyrjes së katër orë pamje filmike, është vënë re se ky i paraburgosur shoqëron lëvizjet e E. Sh. Kuptohet se i paraburgosuri në fjalë është në shërbim të kërkesavë të E. Sh. pasi gjatë gjithë kohës ai i merr dhe dorëzon sendet e tij nga një sektor në tjetrin dhe qëndron në pritje në urdhërave të radhës duke bërë ece-jake nëpër koridor. Në orën 10:56:50, E. Sh. i shoqëruar me dy të paraburgosurit e lartpërmendur futet në dhomën nr.6 ku F. D. po qëndronte në pritje të takimit me familjarët. Grupit i është bashkuar edhe një i paraburgosur tjetër në orën 10:57:20, i cili me shumë mundësi është bartësi tjetër i sendeve pasi edhe ky lëviz shpesh në koridor me çanta në duar. Në orën 10:57:33 të katër të paraburgosurit dalin nga dhoma nr.6. E. Sh. largohet për në sektorin e dhomave të banimit, ndërsa tre të paraburgosurit e tjerë që i erdhën në krah qëndrojnë për disa minuta para dhomës nr. 6, deri kur F. D. merr takim me familjarët. Dy të paraburgosurit bartës vazhdojnë lëvizjet nëpër sektor për të shpërndarë pakot dhe çantat ndërsa i paraburgosuri i tretë shkon për në dhomat e banimit në orën 11:08:26. Të gjitha këto lëvizje kanë ngjarë jashtë vëmendjes së punonjësve të policisë, të cilët nuk kanë pasqyruar në regjistra rastin.

Legjislacioni në fuqi ngarkon me përgjegjësi punonjësit e policisë që të ruajnë sigurinë në IEVP. Administrata e IEVP-ës duhet të bëjë përpjekje për të mbrojtur të burgosurit e rrezikuar nga kërcënimet dhe keqtrajtimet nga ana e të burgosurve të tjerë. Rastet që nxjerrin në pah probleme për tu zgjidhur duhet të pasqyrohen dhe të raportohen. (neni 11/1 i Ligjit 10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, neni 26/2 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve dhe neni 23/q i Rregullores “Për rregullat e hollësishme të Punonjësve të Policisë së Burgjeve”)

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut” si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”

J U R E K O M A N D O J M Ë:

Marrjen e masave për disiplinimin e veprimeve që kryehen në sektorin e dhomave të takimit me avokatin, prokurorin, familjarët etj., në IEVP në Rrugën “Jordan Misja”, vendosjen e numrave për çdo dhomë takimi, shënimin e saktë në regjistra të dhomës se ku i paraburgosuri është dërguar për të marrë takim dhe me kë ka marrë takim, pasqyrimin e ngjarjeve që ndodhin në regjim si dhe vendosjen e kamerave cilësore.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", lutemi të vihem i në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI